

**DEPARTEMENT  
BILDUNG, KULTUR UND SPORT**  
Abteilung Volksschule

Shkurt 2020

**Informacione për kalim prej kopshtit parashkollor (Kindergarten) në shkollën fillore të ulët  
(Primarschule)**

---

**Procedura e propozimit për kalim prej kopshtit parashkollor në shkollën fillore të ulët**

Kalimi prej kopshtit parashkollor në shkollën fillore të ulët bëhet në bazë të propozimit nga personeli mësimor i kopshtit parashkollor. Kriteri kryesor për rekomandimin është zhvillimi i mëparshëm i fëmijës në lidhje me kompetencat e përshkruara në kurrikulën Aargau dhe parashikimin për zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave. Biseda për kalim dhe propozimi i dhënë mbështetet në dosjen vlerësuese. Aty vë personeli mësimor i kopshtit parashkollor gjatë vitit shkollor shumë punime dome-  
thënëse të fëmijut (p.sh. punime individuale, vizatime, fotografitë e artizanatit, vetëvlerësimet e fëmijës etj.). I mbështetur në dokumente në dosjen vlerësuese sqaron dhe e arsyeton personeli mësimor i kopshtit parashkollor te prindërit propozimin për kalim.

Te propozimi për kalim në shkollën fillore të ulët personeli mësimor i kopshtit parashkollor e merr pa-  
rasysh zhvillimin e fëmijut. Në raste të veçanta mundet kalimi të bëhet në klasën e parë dy vjeçare  
(Einschulungsklasse) apo një ofertë e përshtatshme për fëmijë apo të rinjë me nevoja të posaçme  
shkollore.

**Procedura (ecuria)**

Gjatë vitit të 1 të kopshtit parashkollor mundet personeli mësimor i kopshtit parashkollor me prindërit sipas pyetësorit për vlerësim (Einschätzungsbogen) ta bëjë një bisedë për gjendjen e zhvillimit të fëmijut. Në vitin e dytë të kopshtit parashkollor personeli mësimor është i detyruar që ta zhvilloj një bisedë për kalim në kohën prej shkurti deri në prill ku me dëshirën e prindërve dëgjohej edhe fëmiju.

Personeli mësimor i kopshtit parashkollor dhe prindërit bëjnë marrveshjen me shkrim nëse janë dy palët të pajtimit me propozimin për kalim. Nëse nuk ka marrveshje dhe diferencat nuk mund të kalo-  
hen me bisedat në vazhdim (prindër, personeli mësimor i kopshtit parashkollor, udhëheqësi i shkollës) vendos Bordi i Shkollës (Schulpflege) për kalim. Para këtij vendimi prindërit kanë mundësin, që t'i paraqesin argumentet e tyre Bordit të Shkollës. Procedura e vendimit përfshirë ecurin se si ka ardhë deri te vendimi si edhe mundësin për ankesë ju dërgohet prindërve nga Bordi i shkollës me shkrim. Prindërit kanë mundësin kundër këtij vendimi mbrenda 30 ditësh nga pranimi i këtij vendimi të ankohen te Këshilli Rajonal i Shkollës (Schulrat des Bezirks).